

BULETINI I IGJK

Tetor 2003

Ky buletin është publikuar për informimin sa më të plotë të gjyqesive të Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafet e IGJK në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

Të shohim dhe shkojmë përpara më shumë se mund të mendojmë dhe shohim

Mundësi speciale edukimi

Udhëtimi në përgjithësi dhe kryesisht është frymëzues dhe informues. Bënë zgjerimin e horizontit, ndihmon në marrjen e sygjërimeve motivon në përmirsimin e aftësive dhe njohurisë. Kjo është arsye që e legjitimon Institutin gjyqësor të Kosovës (IGJK) të organizon udhëtim-studime dhe programe-edukative për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës, të cilët kanë qenë të përjashtuar një kohë të gjatë nga sistemi modern i zhvillimit gjyqësor në Evropë dhe mëturjtë në botën perëndimore që tani janë të etur për tu orientuar në procesin e tranzicionit të sistemit ligjor. Kjo është mënyra e kyçjes së partnerëve në bashkimin ndërkombëtar. Pjesëmarrësit e udhëtim-studimeve dhe programeve-edukative, të cilët hyjnë në kontakt me kolegët e tyre në vende të huaja, gjithashtu do të gjejnë miratimin e njohurive të veta, duke pasur parasysh miratimin e pasurisë së traditës dhe praktikës së tyre si dhe të jenë të vetëdijshëm për

ekzistencën e pranuar dhe të respektuar.

(IGJK-ja) ka ofruar udhëtim-studime dhe programe-edukative në, Gjermani, Francë, Holandë, Poloni, Luksemburg, Slloveni, dhe Kroaci, kurse një udhëtim-studimi planifikohet për në Bullgari. Të tjera vende në Evropë si dhe në Ballkan janë në vijim. Disa vizita të punës gjë më tani janë mbajtur në Konstanz/ Gjermani. Në fillim të tetorit një vizitë e punës do të fillojë në Gera/ Gjermani, i vendosur në Turingjia, pjesë e mëparshme të Republikës Demokratike të Gjermanisë. Një udhëtim-studimi i ri për në Gjermani është i planifikuar me datën- 9.11. – deri me 15.11.2003. Pjesëmarrësit të selektuar janë: gjyqtarët Mejreme Zekaj, Meleqe Bexheti, Vjollca Rizaj, Selman Bogiqi, Ragip Zeneli, Fehmije Zhubi, Jonuz Bugari dhe prokurorët Ismat Ujkani, Vazhit Idrizi dhe Slobodan Stevanovic.

Synimet e vizitave studimore dhe të punës

Përveç efektve të përmendura dhe të dëshiruara në zgjerimin e horizontit të pjesëmarrësve, **vizitat studimore** mund të ndihmojnë në caktimin e kontakteve të



gjyqëtarve dhe prokurorve dhe në përmirsimin e bashkpunimit me koleget e jashtëm veçanërisht ndihmë të fushatës ligjore dhe ekstradimin reciprok. Ata do të marrin njohuri të metodave moderne në shkatërrimin e krimit nëpërmjet menagjimit modern.

Në lidhje me rritjen e integritit të Kosovës në familën ndërkombëtare dhe pikërisht pasi që populli Kosovare të gjindet nepër krejt botën, bashk-operime dhe instrukcione të tilla janë të nevojshme. Duhet të fitohet përvoja në trajtimin e rregullave të ligjit ndërkombëtar privat dhe publik. Standardet e rendit ligjor ndërkombëtar, realizimi e të drejtave të njeriut në këtë procedurë duhet mësohen. Është e dobishme për punën gjyqësore në Kosovë të zbulohet se si gjykatat janë duke funksionuar dhe si është i organizuar bashkpunimi në mes të gjykatave dhe zyret e prokurorisë si dhe me policinë. Andaj, modeli përkatës për punën personale do të mund të gjindet në sistemin e konsoliduar ligjor të Evropës.. Është interesante gjithashtu për të shikuar se si pjesët e mëparshme të ligjit RFJ kanë mbizotëruar problemet në tranzicionin gjyqësor.

Udhëtim-studimet do të shoqërohen me anë të trajnuesve vendor apo ndërkombëtar të IGJK, sipas eksperiencës korresponduese dhe qëllimet e zgjedhura të udhëtim-studimeve. Udhëtim-studimet do të përforcojnë moralin e grupit, duke përfshirë përfaqësuesit e minoriteteve.

Për dallim nga udhëtimet studimore, **vizitat e punës** kanë për qëllim të japin impresione të forta mbi punën e përditëshme të kolegëve nga jashtë. Ato zakonisht zgjasin 3 javë. Gjyqëtarët dhe prokurorët e dërguar - gjithësejt 2 apo 3, do të përcjellin seancat në gjykatat apo në zyret e prokurorisë. Ata duhet të përgadisnin rastet së bashku me koleget udhëheqës. Prandaj gjyqëtarët dhe prokurorët të cilët aplikojnë duhet të kenë njohuri të gjuhës së vendit në të cilin udhëtojnë. Parakusht i tillë kufizon numrin e kandidatve të përshtatshëm. Të punohet me përkthyes, me dallim nga udhëtimet studimore, nuk është i mundur.

Sfidat e udhëtimeve studimore dhe të punës

Mundësitë e edukimit janë atraktive dhe interesi është i madh. Udhëtime të tilla janë nxitëse për IGJK dhe OSBE me interes në përpjekje për organizim dhe plotësim të nevojave financiare. Kjo mund të demonstron sipas orarit të udhëtim-studimit për në Gjermani, ku përafërsisht 150 kandidat kanë konkuruar vetëm për 10 pozita. Pas planifikimit gjeneral të udhëtim studimor në programin vjetor të IGJK dhe pasqyrimin më konkret të buxhetit, duhet themelohet programi konkret, me ndihmën e kolegëve Gjerman. Udhëtime duhet të shpallet përmes buletinit mujor të IGJK dhe ftesave duhet të dërgohen të gjithë gjyqëtarve dhe prokurorve të Kosovës, të përkthyer nga asistentet e gjuhës të IGJK në gjuhën Shqipe dhe



Serbe. Zyrtëer të sundimit të së drejtës të OSBE-së duhet të përcjellin informatën tek gjyqtarët dhe prokurorët në regjonet e tyre. Kryetarët e gjykateve veçmas do të janë të informuar, dhe kërkohet nga ata ti informojnë koleget e tyre. Procesi selektimit do të ndërmirët, thuajse me rraskapitje të gjitha kapaciteteve të personelit të pamjaftueshëm të Institutit gjyqësor të Kosovës: zyrtari më i lartë administrativ koleksionon aplikacionet, verifikon kandidatin a ka qen i dërguar jashtë vendit më parë dhe ekzistimin e pengesave të tjera si p.sh i dokumentacioni valid i mangët; bashkë-drejtori vendorë dhe trajnuesi gjyqësor përgjegjës duhet ta bëjnë selektimin e kandidatve të përshtatshëm. Kjo do të thot se duhet respektuar të gjitha regjionet dhe nivelet e gjykatave, duhet marrur në konsiderat që kandidatët e dy gjinive të janë të përfaqësuar, që gjithashtu minortetet të përfshihen, etj. Pastaj rezultati publikohet, dhe ai sjell reagim pozitiv tek kandidatet e selektuar si dhe zhgënjim tek të tjerët. Tani ne duhet të kërkojm vizat, biletat dhe të kujdesemi për nevoja të tjera në lidhje me këtë udhëtim studimor. Kjo do të zmadhoj punën e personelit të IGJK

siç janë zyrtari I financave, asistenti administrativ dhe shoferi. Pas përfundimit të udhëtimit studimor ose të punës, koleget do të ndajnë eksperiencen e tyre me koleget përmes mbledhjeve të caktuara nga IGJK.

Deri më tani OSBE ka furnizuar IGJK me buxhet të nevojshëm. Këshilli i Evropës Qeveria Gjerman si dhe Zvicrrane poashtu kan paguar për programe tona dhe shpresojm se do të vazhdohet edhe në te ardhmen, megjithëse Instituti gjyqësor i Kosovës do të bëhet shkollë lokale e magjistraturës dhe mjetet për financim dhe mundësi për fonder janë më të rralla. Përkundër këtyre vështërsive, udhëtimet studimor dhe të punës janë të kënaqshme për trainuesut të involvuar dhe stafin, të cilet janë të prekur nga interesi dhe angazhimi I madh i pjesëmarrësve. Ky është një motivim për të vazhduar me përpjekje të tilla.

Dr .jur.Horst Proetel, Trajnues Gjyqësor
në IGJK
gjyqëtar dhe instruktor i mëparshëm në
Gjermani

Aktivitet në tetor 2003.

- Trainimi mbi Kodet e reja të përkoshme penale
- Trainimi mbi terorizmin, krimin e organizar, mbrojtjen e viktimave dhe qështjet tjera përkatëse si dhe mbi praktikat gjyqësore
- Progami i edukimit jash vendit



Trainimi mbi Kodet te reja të përkohshme penale

3.-4. tetor 2003.

Trainimi kryesor në fillimin e tetorit është trainimi mbi kodet e reja të përkohshme penale. Është i caktuar për 3 dhe 4 tetor dhe do të mbahet në Shkollën e shërbimit policor në Vushtrri. Ky trainim është i organizuar në bashkpunim me shumë partner, si që janë OSBE, KE, DD, SHSHPK dhe të tjerët. Pjesëmarrësit do të jenë gjyqtarët, prokurorët publik, avokatët dhe përfaqësuesit të SHSHPK. Pasi që pritet pjesëmarrja e lartë e përfaqësuesve të grupeve të cekura, pjesëmarrësit do të ndahen në dy grupe, njëri të premtën tjetri të shtundën, kështu që pengimi i punës së gjykatave do të jetë i vogël. Pas vërejtjeve hyrëse që do të ipen nga personat të lartë të komunitetit ligjor, Keshilltari ligjor UNMIK dhe përfaqësuesit të zyrës së tij do të japin prezentimin e kodeve të reja ndërkaq për përmbledhjen e ndyshimeve do të flasin ekspertët lokal dhe ndërkombëtar-këshilltarët të KE, të cilit kanë punuar së bashku në procesin e draftimit.

Trainimi mbi terorizmin, krimin e organizuar, mbrojtjen e viktimave dhe çështjeve tjera përkatëse si dhe praktikën gjyqësore

17.-18.tetor 2003

Ky trainim për gjyqtarët dhe prokurorët publik vendor dhe ndërkombëtar, organizohet nga IGJK, Departmenti i drejtësisë dhe ICTY. Temat e ditës së parë do të jenë: definimi i terorizmit sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/12, krimi i organizuar si që është i definuar në Rregullorën e UNMIK-ut 2001/22, mbrojtja e viktimave-praktika dhe legjislacioni, masat e fshehta sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2002/6, mediat dhe procedura penale, ndërkaq temat e ditës së dytë do të jenë: legjislacioni mbi denimet si dhe praktika dhe zbatimi i diskrecionit gjyqësor. Trainimi do të jetë kombinim i prezentimit, diskutimit dhe studimit të rasteve.

NGJARJET TJERA – TE ARDHSHME

Programi i edukimit jashtë vendit

Pas përfundimit të vizitës studimore Zvicrës me 23-30 gusht, IGJK bënë përgatitje për një vizitë të punës dhe një vizitë studimore në Gjermani. Vizita e punës planifikohet prej 5.-25. tetor 2003. për dy gjyqtar/prokuror publik ndërsa vizita studimore për 9.-15. nëntor 2003. për përfaqësuesit 10 magjistratë.

Përgatitjet për vizitën studimore në Bullgari janë në rrjedhim.



